



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:088247
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05640302

C.nr.412/19

GJYKATA THEMELORE PEJË - Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtar Vegim Maloku , në çështjen juridiko- kontestimore të paditëses Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.A. Rr. Ukshin Hoti nr.29 Prishtinë të cilën e përfaqëson A.S. jurist, kundër të paditurve, A.B. nga P. të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Osman Cucoviq avokat në Pejë, E.B. dhe R.B. që të dy nga P., nga baza juridike: kthim borxhi, me vlerë kontestit: 14,458.54 euro në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe përfaqësuesit të përkohshëm e në mungesë të paditurve të dytë dhe të tretë, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe publike, me dt. 26.04.2024, mori kurse me datë 30.04.2024 përpiloj ketë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT E BAZUAR, kërkesëpadia e paditëses Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.A dhe DETYROHEN të paditurit A.B. dhe R.B që të dy nga P., që solidarisht paditëses t'ia paguajnë borxhin nga marrëveshja për kredinë e dt.14.03.2017, ashtu që në emër të kryegjësë (principalit) shumë prej 10,773.34 euro, në emër të interesit të rregullt shumë prej 2,050.49 euro dhe kamatë vonesës në shumë prej 1,724.72 euro, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1232 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënimin të përmbarrimit me detyrim.
- II. REFUZOHET E PA BAZUAR pjesa e kërkesëpadisë së paditëses me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET i padituri E.B. që paditëses në emër të borxhit për kredinë e datës 14.03.2017 solidarisht me të paditurit e tjerë të ia paguajë, në emër të

kryegjësë (principalit) shumë prej 10,773.34 euro, në emër të interesit të rregullt shumë prej 2,050.49 euro dhe kamatë vonesës në shumë prej 1,724.72 euro, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1232 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënimin të përmbartimit me detyrim.

A r s y e t i m

I. Historiku i procedurës:

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.A. Rr. Ukshin Hoti nr.29 Prishtinë të cilën e përfaqëson A.S. jurist, kundër të paditurve, A.B. nga P. të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Osman Cucoviq avokat në Pejë, E.B. dhe R.B. që të dy nga P., nga baza juridike: kthim borxhi, me vlerë kontestit: 14,458.54 euro .

Gjykata ka tentuar që të komunikojë me të paditurën e parë, por një gjë e tillë ka qenë e pamundur, ashtu që të njëjtës i ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm avokatin Osman Cucovic, kurse sa i përket të paditurit E.B., fillimisht i njëjti ka komunikuar me gjykatën, por më pas ka ndërruar vendbanim duke mos e njoftuar gjykatën për një gjë të tillë, andaj komunikimi me të është bërë përmes tabelës së shpalljes së kësaj gjykate, ndërsa i padituri R.B., ka pranuar ftesat në mënyrë të rregullt, por asnjëherë nuk është paraqitur në gjykatë, andaj shqyrtimi është mbajtur në mungesë të këtyre dy të paditurve.

Përfaqësuesi i paditëses, pas pranimit të plotësimit ekspertizës financiare, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke e bërë zmadhim të kërkesës, të cilën gjykata pasi që ka njoftuar dhe të paditurit, ka lejuar këtë precizim në seancën e datës 26.04.2024.

I. Pretendimet e ndërgjyqësve:

I autorizuari i paditëses me padi, ka theksuar se BKT me të paditurit A.B. në cilësinë e kredi marrëses dhe të paditurve E. dhe R.B. në cilësi të bashkë kredi marrësve me datë 14.03.2017 kanë nënshkruar kontratën e kredisë bankare të regjistruar tek kreditori me numër 7.... në shumë prej 13,000 euro, destinimi i të cilës ka qenë për mbyllje të kredisë dhe renovim të shtëpisë. Kjo kontratë ishte lidhur për një afat prej 84 muaj, e të cilën kanë pasë për obligim që ta paguajnë në

baza mujore, me normë efektive të interesit prej 6.86 %. Të paditurit, nuk i janë përmbajtur planit të pagesave dhe nuk kanë paguar kredinë sipas planit të pagesave, ashtu që pa paguar ka mbetur shuma prej 11,266.22 euro. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i palës paditëse ka qëndruar pranë padisë, kurse pas nxjerrjes së ekspertizës financiare, kanë precizuar kërkesë padinë në shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në fjalën përfundimtare, i autorizuari i palës paditëse ka cekur se nga provat e administruara e në veçanti ekspertizës financiare, janë vërtetuar pretendimet e palës paditëse, andaj nga gjykata kanë kërkuar që të aprovohet padia në tërësi e bazuar dhe të paditurit të obligohen që paditëses të ia paguajnë borxhin në lartësi prej 14,458.54 euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 1250 euro.

Përfaqësuesi i përkohshëm, i të paditurës së parë A.B., në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e palës paditëse, sepse padia nuk jep fakte të mjaftueshme në të cilat mbështetet e me çka do të bëhet e besueshme baza e padisë, e po ashtu nuk jepen argumente në drejtim të identifikimit të palës së paditur, respektivisht nuk provohet legjitimiteti pasiv i të paditurës. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka qëndruar pranë përgjigjes në padi, duke kërkuar nga paditësja që të ofroj prova materiale që e paditura ka rënë në vonesë, kurse në fjalën e tij përfundimtare ka mbetur në kundërshtimet e tij, kurse nga gjykata ka kërkuar që të sjellë në vendim të drejtë.

Shpenzimet në emër të përfaqësuesit të përkohshëm i ka kërkuar në lartësi prej 987 euro.

Të paditurit dy dhe tre, edhe përkundër faktit se kanë pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, përgjigje në padi nuk kanë dhënë, gjithashtu për seancën e shqyrtimit gjyqësor kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt mirëpo nuk kanë prezantuar, andaj gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka mbajtur në mungesë të paditurve, konkretisht konform nenit 409 (seancën përgatitore) dhe nenit 423 (seancën e shqyrtimit kryesor) të LPK-së.

II. Provat e administruara:

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike sipas propozimit të autorizuari të paditëses gjykata ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova: Kontrata e kredisë bankare me numër 7..... e dt. 14.03.2017 e lidhur në mes paditëses dhe të paditurve, marrëveshja mbi pengun

me numër5 e dt. 14.03.2017 e lidhur në mes paditëses dhe të paditurës A.B., aneksi i planit të pagesave i lëshuar nga BKT për klientën A.B., dt. 16.03.2017, raporti i të dhënave të borxhit i dt. 08.04.2019 për A.B., kopja e lejes së njoftimit për A.B., ekspertiza financiare e dt. 11.12.2023 dhe plotësim ekspertiza financiare e dt. 20.02.2024 e përpiluar nga eksperti financiar Muhamet Muriqi.

III. Vlerësimi i provave

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës paditëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Gjykata në këtë çështje juridike, nga gjendja e fakteve dhe provave të çështjes, ka gjetur pjesërisht si të vërtetuar faktin se në mes palëve ndërgjyqësve ka ekzistuar marrëdhënia kontraktuale për marrjen e kredisë, e cila ka ekzistuar në mes të paditëses BKT dhe të paditurve A.B dhe R.B., me çka, në mes palëve ndërgjyqësve janë krijuar të drejta dhe detyrime dhe rrjedhimisht detyrimi për përmbushjen e tyre.

Deri tek vërtetimi i kësaj gjendje gjykata ka ardhur duke u bazuar në marrëveshja për kreditë me numër 7..... e dt. 14.03.2017, sipas të cilës vërtetohet se palët ndërgjyqëse BKT dhe të paditurve A.B dhe R.B., kishin lidhur marrëveshje për marrjen e kredisë, e sipas të cilës marrëveshje pala paditëse kishte cilësinë e Kredi dhënësit, kurse e paditura A. cilësinë e Kredi marrësit, ndërsa i padituri R. kishte cilësinë e bashkë – kredi marrësit. Objekt i kësaj kredie, sipas neni 2 të kësaj marrëveshje, ishte shuma prej 13,000 euro, ku kredi dhënësi u kishte dhënë këtë kredi kredi marrësve me destinim për mbyllje të kredisë dhe renovim të shtëpisë. Sipas në njëjtin nen të kësaj kontrate në par.3 të nenit 2, kredi marrësit kishin marrë përsipër të paguajnë këtë kredi së bashku me interesin, kurse në nenin 3 të kontratës parashihej që afati për përmbushje ishte 84 muaj kurse kjo shumë prej 10,000 euro do të disbursohet në llogarinë e A.B. kurse pjesa, ndërsa me nenin 5 vërtetohet norma e interesit e aplikuar për kredi për 5 vitet e para është 6.50 %, kurse norma efektive është 6.86 %. Tutje, në këtë kontratë në nenin 8 të saj, është paraparë që pagesa e kësteve të bëhet sipas planit të pagesave në aneksin 1. Bazuar në nenin 10 të po kësaj kontrate, shuma prej 10,000 euro do të transferohet në bazë të faturave dhe pro faturave të rregullta, kurse kredi marrësit po ashtu kanë marrë përsipër që të bëhet edhe

mbyllja e kredisë në BKT bank në shumë prej 5,466 euro.

Krejt në fund të kësaj marrëveshje për kredi, janë nënshkrimet e personave nga ana e zyrtarëve të paditëses si dhe të paditurve A.B. në cilësi të kredi marrësit dhe R.B. në cilësi të bashkë kredi marrësit.

Duhet cekur se në këtë kontratë, figuron edhe emri i të paditurit E.B. në cilësi të bashkë kredi marrësit, por që i njëjti nuk është i nënshkruar në këtë kontratë.

Përmes Aneksit i planit të pagesës e që është orari i kthimit të kredisë lidhur kredinë në shumë prej 13,000 euro, parashihen periudhat e kthimit të kredisë, nga e cila vërtetohet se afati i kthimit të kredisë është 84 muaj, duke filluar nga data 16.05.2017 e deri me datën 07.03.20122, me kësht mujor prej 192.79 euro. Edhe kjo shtojcë e orarit të kthimit të kredisë është e nënshkruar nga e paditura e parë dhe zyrtarët e paditësit. Kjo shtojcë e kthimit të kredisë, në fakt sipas nenit 8.2 të marrëveshjes së sipër cekur, kthimi i kredisë apo ri pagimi i saj do të bëhet sipas shtojcës 1 e që është kjo shtojcë që është administruar si provë.

Palët ndërgjyqëe, kishin lidhur edhe një marrëveshje mbi pengun me numër 7201136475 e dt. 14.03.2017, e nënshkruar nga pengmarrësi BKT dhe pengdhënësit A.B.. Nga kjo marrëveshje gjykata vërtetoi se peng dhënësja në këtë rast e paditura e parë, si peng kishte lënë pagën që e realizon nga punëdhënësi e i cili peng do të merret për të siguruar pagimin, përmbushjen dhe shlyerjen e kredisë në shumën prej 13,000 euro sipas kontratës për kredinë me numër 7.... e dt. 14.03.2017.

Nga raporti i të dhënave të borxhit i dt. 08.04.2019 për A.B. gjykata vërtetoi se me datën 08.04.2019, e paditura A.B., si borxh të pa paguar në emër të principalit kishte shumën prej 10,773.34 euro, interes shumën prej 389 euro, kurse kamatë vonesë shumën prej 1,059.77 euro, ndërsa nga kopja e lejes së njoftimit për A.B., gjykata vërtetoi identitetin e të paditurës së parë.

Këtyre provave materiale, gjykata u ka falur besimin në tërësi, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar nga palët në procedurë dhe se përmes tyre gjykata ka vërtetuar raportin juridik që palët kishin mes vete, si dhe të drejtat dhe detyrimet që kanë rrjedhë nga një raport i tillë.

Sa i përket borxhit të cilin pala paditëse pretendonte se të paditurit e kanë obligim, një gjë e

tillë u vërtetua përmes ekspertizës financiare dhe plotësim ekspertizës të ekspertit Muhamet Muriqi. Përmes kësaj ekspertize dhe plotësim ekspertizë, gjykata ka vërtetuar se palët e paditura, si borxh të akumuluar tek paditësja, kanë shumën e kryegjësë në lartësi prej 10,773.34 euro, shumën e kamatëvonesës së kontraktuar prej 1,724.72 euro interes shumën prej 2,050.49 euro, e që në total si detyrim është shuma prej 14, 458.54 euro. Nga kjo ekspertizë, gjykata vërtetoi se palët e paditura kishin paguar vetëm shumën prej 2,226.66 euro. Gjykata kësaj ekspertize i ka falur besimin në tërësi, pasi që e njëjtë është përpiluar sipas kërkesave të gjykatës, pra është në harmoni me detyrat e dhëna. I autorizuari i palës paditëse nuk kishte vërejtje në këtë ekspertizë e as përfaqësuesi i përkohshëm

Për më tepër, gjykata ka ftuar në sqarim ekspertin sipas detyrës zyrtare, i cili ka prezantuar në seancën e datës 26.04.2024, ku kishte qëndruar në tërësi pranë ekspertizës dhe plotësim ekspertizës dhe se nuk kishte më shumë për të shtuar, por ka sqaruar se pasi që gjykata i ka kthyer në plotësim ekspertizën, nga kalkulimet të cilat i ka bërë, ka rezultuar se borxh i pa paguar sipas kontratës për kredinë është shuma prej 10,773.34 euro për kryegjë, shumën e kamatëvonesës së kontraktuar prej 1,724.72 euro interes shumën prej 2,050.49 euro. I autorizuari i palës paditëse dhe përfaqësuesi i përkohshëm nuk kishin pyetje për ekspertin e as vërejtje në deklarin e tij.

Bazuar në këto, gjykata ka vërtetuar se pjesa e obligimit të paditurve A. dhe R.B. në raport me paditësen është në shumën prej 10,773.34 euro për kryegjë, shumën e kamatëvonesës së kontraktuar prej 1,724.72 euro interes shumën prej 2,050.49 euro. Andaj, gjykata kërkesëpadinë e paditëse e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar, pasi që e njëjta është e mbështetur në prova dhe të njëjtat janë në përputhje me pretendimet e paditëses.

IV. Baza ligjore dhe vlerësimet e gjykatës

Të paditurit A. dhe R. duke mos e kryer detyrimin e tyre, rezulton se i kanë mbetur borxh paditëses shumën e cekur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqësve është krijuar raporti detyrimor, ne të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa të paditurit A. dhe R. e kanë cilësinë e debitorit.

Gjykata me këtë rast thekson se ligj i aplikueshëm është Ligji nr. 04/L-077 Për Mardhëniet e Detyrimeve, ku në nenin 8 parag.1 parasheh se “*Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë*

të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”, ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LDM-së, ka paraparë se “Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”.

Duhet theksuar se pjesëmarrësit në marrëdhëniet detyrimore, duhet të udhëhiqen nga disa parime bazë, mbi të cilat ndërtohen raportet e tilla kontraktuale. Çka do të thotë kjo se, palët në këtë rast, duhet të nisen nga parimi bazë në raportet detyrimore, e që është autonomia e vullnetit e inkorporuar në nenin 2 të LMD-së, sipas të cilit, pjesëmarrësit janë të lirë në krijimin e raporteve të tyre, dhe se të njëjtit janë të barabartë me këto marrëdhënie (neni 3 LMD). Si rrjedhojë e tërë kësaj, nxjerrët përfundimi se palët janë të obliguar që të zbatojnë atë për çka edhe janë pajtuar. Kjo është e njohur dhe në maksimumin e njohur juridike “*pacta sunt servanda – kontrata është ligj për palët*”. Pra, sipas kësaj, kjo marrëveshje në mes të palëve, ka qenë e lidhur duke u mbështetur në parimin “*bona fides – në mirëbesim*”. Në kuptim të kësaj, palët duhet të përmbahen nga keqpërdorimi i pozitës që kanë në raportin kontraktual dhe të qëndrojnë pranë asaj për çka janë dakorduar.

Pala e paditur, me mos përmbushjen e detyrimit në raport me paditësin, të njëjtin e ka vënë në një pozitë të vështirë, sepse palët tek kontratat e tilla të dyanshme, nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke, neni 7 par.1 i LMD-së “*Në krijimin e kontratave me shpërblim, pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke*”, ku paditësi ka përmbushur në tërësi obligimin e tij duke u dhënë shumën e të hollave në emër të kredisë, mirëpo e njëjta gjë nuk ka ndodhur edhe nga të paditurit A. dhe R., të cilët nuk kanë kthyer shumën e kredisë sipas marrëveshjes. Me këtë rast, palës paditëse i rrjedh e drejta për të kërkuar përmbushjen e detyrimit nga të paditurit. Po ashtu, nuk duhet harruar se të drejtat dhe detyrimet që derivojnë nga raportet detyrimore, duhet të ushtrohen në pajtim me parimet e LMD-së, neni 6 par.1 i LMD-së “*Të drejtat që rrjedhin nga marrëdhëniet e detyrimeve duhet të ushtrohen në pajtim me parimet themelore të këtij ligji dhe qëllimin e tyre*”, dhe se gjatë ushtrimit të këtyre të drejtave, palët duhet të përmbahen nga veprimet të cilat e vështirësojnë pozitën e palës tjetër e shkelja e një parimi të tillë, konsiderohet si keqpërdorim i të drejtës, neni 6 par. 2 “*Gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre, pjesëmarrësit në një marrëdhënie detyrimi duhet të përmbahen nga veprimi që do të mund të vështirësonte kryerjen e detyrimeve të pjesëmarrësve të tjerë*” dhe 3 “*Çdo veprim përmes të cilit bartësi i një të drejte vepron me qëllimin e vetëm ose të qartë të dëmtimit të tjetrit konsiderohet keqpërdorim i të drejtës*” i LMD-së.

Si përfundim i tërë kësaj, palës së paditur i bie barra e përmbushjes së detyrimit të tyre që ka në raport me paditësen, sepse kemi të bëjmë me një marrëdhënie juridike me detyrime të dyanshme, ku secila palë është e obliguar që të përmbushë detyrimet e veta, dhe se të padituri në këtë rast kanë rënë në vonesë duke mos ju përmbajtur planit të pagesave sipas marrëveshjes së tyre, e sipas nenit 305 par.1 të LMD-së “Debitori është në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të caktuar për përmbushje” kurse sipas nenit 375 të LMD-së “Kur detyrimi ka si subjekt një shumë të hollash, debitori ka për detyrë të paguajë shumën e njëjtë të të hollave, përveç nëse kreditori dhe debitori merren vesh ndryshe në pajtim me ligjin.” Detyrimi i të paditurve që solidarisht të përmbushin detyrimin e tyre që kanë në raport me paditësit, parashihet në dispozitën e nenit 398 par.1 të LMD-së “Secili debitor i detyrimit solidar i përgjigjet kreditorit për krejt detyrimin dhe kreditori mund të kërkojë përmbushjen e tij nga cilido që dëshiron, gjithnjë derisa të mos përmbushet krejtësisht, por kur një debitor ta ketë përmbushur detyrimin ai shuhet dhe të gjithë debitorët lirohen”, për shkak se të dy të paditurit kishin lidhur kontratën për marrjen e kredisë bashkërisht.

Për gjykatën, si fakt vendimtar në këtë çështje kontestimore, na paraqitet fakti se fillimisht ishte lidhur marrëveshja për kredi, që u provua përmes marrëveshjes së kredisë të administruar si provë dhe fakt tjetër vendimtar është se të padituri nuk i ishin përmbajtur kësaj marrëveshje, e që u provua përmes ekspertizës financiare, e për çka edhe u aprovua si e bazuar kërkesëpadia si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke ju referuar dispozitës së nenit: 7 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të ligjit të procedurës kontestimore, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë t’i provoji faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Pala e paditur R. me këtë rast, kishte lëshuar mundësinë e dhënies së prapësimeve materiale apo edhe procedurale në këtë procedurë.

Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të përkohshëm sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata me këtë rast sqaron se e paditura e parë në këtë raport detyrimore kishte cilësinë e kredi marrëses, andaj ajo për veten e saj me rastin e nënshkrimit të kontratës për kredi ka krijuar të drejta por edhe detyrime e të cilat është e obliguar që të përmbushë. Sa i përket pretendimit tjetër se pala paditëse nuk ka dëshmuar nëse e ka njoftuar të paditurën se ka rënë në

vonesë dhe se nuk ka dëshmuar se sa është shuma që ka paguar e paditura e parë, një gjë e tillë nuk qëndron, sepse e paditura me nënshkrim të kontratës për kredinë dhe planit të pagesave, ka qenë në dijeni për kohën dhe mënyrën e përmbushjes së detyrimit të saj, kurse asaj se sa ajo ka paguar, kjo është vërtetuar përmes ekspertizës financiare që është administruar si provë në këtë çështje.

Pjesa Refuzuese e kërkesëpadisë:

Sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë në raport me të paditurin E.B., gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, nga shkak se nuk u provua se i padituri E. të kishte krijuar ndonjë raport kontraktual me palën paditëse. Siç u tha edhe më lartë, nga kontrata mbi kredinë me numër 7.... e dt. 14.03.2017, ishte nënshkruar nga ana e zyrtarëve të bankës si dhe nga e paditura A. dhe i padituri R., mirëpo një kontratë të tillë nuk e kishte nënshkruar i padituri E., çka do të thotë se i njëjti nuk ka ndonjë obligim në raport me palën paditëse. Bazuar në nenin 8 par. 1 të LMD –së “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.” Pra i padituri E. nuk ishte pjesëmarrës në këtë raport detyrimorë, andaj edhe nuk ka ndonjë obligim për të përmbushur. Neni 15 i LMD-së përcakton se kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës, kurse pala paditëse ka dështuar të provojë se ka pasur ndonjë raport kontraktual apo të ketë ekzistuar ndonjë marrëveshje me të paditurin E.B., e si rrjedhojë i padituri E. nuk ka legjitimitet real pasiv në këtë çështje kontestimore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata ka vendosur konform nenin 452.1 të LPK-së, me çka e ka detyruar të paditurit që paditëses t’ia paguan shpenzimet e procedurës në shumë prej 1232 euro €, 250 euro për ekspertizën financiare kurse 982 euro për shpenzimet për përfaqësues të përkohshëm. Lidhur me shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm, gjykata ka vendosur me aktvendim të veçantë.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 të LPK-së, lidhur me nenin 2,3,6,7,8, 15, 245, 305, 375 dhe 398 të LMD-së.

Gjyqtari
Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes të kësaj gjykate.